

Manuali i përdorimit të aplikacionit

Komuna e Prishtinës ka aprovuar Pakon e Masave Ekonomike për të përkrahur bizneset e Komunës së Prishtinës në këtë fazë të pandemisë COVID-19. Këto masa, me siguri nuk janë të mjaftueshme, por që qëllimi i këtyre masave është ndihma në rimëkëmbjen e bizneseve të goditura nga pandemia COVID-19.

Ky program nënkupton se NVM të Komunës së Prishtinës që kanë pësuar dëme si rezultat i pandemisë COVID-19, mund të kenë qasje në ndihmën që e ofron Komuna e Prishtinës në formë të granteve. Informacione për Grantin e Rimëkëmbjes së Bizneseve.

Grantet janë në dispozicion për bizneset e vogla dhe të mesme të Komunës së Prishtinës të prekur nga pandemia e COVID-19. Aplikimi për grante do të fillon me 23 Nëntor 2020. Këto grante kanë për qëllim të ndihmojnë në pagesat e kostove për rikthimin e bizneseve të Juaja, që kanë pësuar dëme të drejtpërdrejta si rezultat i pandemisë COVID-19. Aplikimet janë të hapura deri më 3 Dhjetor 2020 dhe mund të bëhen përmes butonit Apliko tani në këtë faqe. Lista e përfituesve do të publikohet deri më 7 Dhjetor 2020, ne web faqet e Komunës. Ju lutemi vini re: Humbja e të ardhurave nuk është e përfshirë në këtë program të granteve.

Për të aplikuar për grant duhet të klikoni në butonin “Kliko për grante” si në fig.1 në linkun: <https://granteekonomike.prishtinaonline.com/>




Figura 1 Aplikimi për grant

Duke klikuar në këtë buton, hapet forma si në fig.2, ku në rast se jeni regjistruar më heret duhet ta shkruani emailin me të cilin jeni regjistruar dhe fjalëkalimin dhe të klikoni në butonin kycu. Nëse keni harruar fjalëkalimin, atëherë klikoni në “keni haruar fjalëkalimin dhe ju dërgon në formën ku duhet ta plotësoni emailin me të cilin jeni regjistruar. Pasi klikoni butonin dërigo, do të pranoni një email nga sistemi me linkun me anë të së cilit mund ta ndryshoni fjalëkalimin dhe të kyceni në informatat e juaja.

Nëse ende nuk jeni regjistruar, atëherë klikoni në butonin “Regjistrohu” si në fig.2.




Figura 2 Kycja/Regjistrimi biznesit





Figura 3 Forma regjistrimit

Në hapje të formës së regjistrimit, aplikanti fillimisht duhet ti plotësojë të dhënat personale të cilat janë të gjitha të kërkuara. Tek informatat e biznesit, aplikanti duhet të shënoj numrin fiskal dhe të klikon në butonin “Regjistrohu”. Pas klikimit, hapet forma e pyëtësorit si në fig.3.



Ballina Ndhima SQ **Edlan Hriste** DIL

Ju lutemi plotësoni informatat në vijim

1. A është biznesi i juaj i prekur nga pandemia COVID-19?
 Po Jo

2. A keni aplikuar për ndonjë ndihmë ose grant nga Qeveria e Republikës së Kosovës?
 Po Jo

3. Si është prekur biznesi i juaj nga pandemia COVID-19?
 - Veprimtaria e biznesit është ndërprerë me urdhëresë të Qeverisë së Kosovës?
 - Veprimtaria e biznesit është pamundësuar ose ka rënë për shkak të kufizimit të kontaktit dhe mbajtjes së distancës sociale?
 - Veprimtaria e biznesit është pamundësuar ose ka rënë për shkak të kufizimit të lëvizjes?

4. A është biznesi i juaj qeramarës në ndonjërin nga Ndërmarrjet Publike Lokale në pronësi të Komunës së Prishtinës (Pallati i Rinisë, Ndërmarrja Publike Banesore)?
 Po Jo

5. A ka qenë aktiv biznesi i juaj para pandemisë COVID-19?
 Po Jo

6. A po vazhdoni apo synoni të vazhdoni operacionet e biznesit?
 Po Jo

7. Sa e vlerësoni humbjen e përfaqësitë financiare që ka pësuar biznesi i juaj në të hyra (qarkullim) mujore, në periudhën e pandemisë COVID-19?
 0 _____ Euro


8. A do të përdoret granti për të rimbursuar kostot e pranueshme të bëra nga ju?
 Po Jo

Detajet e bankës ku është i regjistruar biznesi

Emri i Bankës
 - Zgjedh banken -

Emri i llogarisë

Llogaria bankare

I'm not a robot  reCAPTCHA
 Privacy - Terms

APLIKO

Figura 4 Pytësori

Pas plotësimit të pytësorit dhe detajeve të bankës së biznesit, duhet të klikoni në butonin “Apliko” dhe do të pranoni një email nga sistemi duke ju njoftuar se aplikimi juaj është kryer me sukses.




Figura 5 Editimi profilit

Në rast se keni gabuar gjatë plotësimit të aplikacionit/pytësorit, mund të klikoni në butonin edito aplikacionin për ti përditësuar shenimet. Në rast se keni gabuar në numrin fiskal, atëherë mund të klikoni më butonin edito biznesin ku do tju shfaqen informatat e juaja si: emaili, data e aplikimit, dhe numri fiskal i cili është i editueshëm.

Pas përfundimit të regjistrimit, të dhënat e biznesit do të verifikohen në Administratën Tatimore të Kosovës.